



NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtarja Raima Elezi, si kryetare e trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu, në lëndën penale kundër të akuzuarve [redacted] dhe [redacted], të dytë nga fshati [redacted] Pejë, për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 3 në lidhje me nenin 31 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorit të Shtetit në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.58/17 të dt.05.05.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Genc Nixha dhe të akuzuarve, më datën 29.06.2017, publikisht morri dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

[redacted] A, me nofkën [redacted] nga i ati [redacted] dhe e ëma M [redacted] e vajzërisë Z [redacted] i lindur më dt. [redacted] në fshat. [redacted] Pejë ku edhe jeton, i martuar, babai i 2 fëmijëve, me profesion menaxher i marketingut në firmën "[redacted]", ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa dënuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal [redacted].

B [redacted] H [redacted], nga i ati Z [redacted] dhe e ëma Sh [redacted] e vajzërisë U [redacted] e lindur më [redacted] në fshatin [redacted] e KK Suharekë, tani me banim në fshatin [redacted] KK Pejë, e martuar, nëna e dy fëmijëve, punëtore në [redacted] Pejë, ka të kryer shkollën fillore, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me nr. personal [redacted].

JANË FAJTORË

Sepse

Me datë 24.03.2017 rreth orës 19:00 në Suharekë, i akuzuari M [redacted] R [redacted] vënë në qarkullim si të vërtetë paranë e falsifikuar prej 50 € në atë mënyrë që pasi kishte pas në posedim paranë e falsifikuar e me qëllim që paranë në fjalë të vënë në qarkullim si të vërtetë ia dorëzon bashkëshortes së tij të akuzuarës B [redacted] H [redacted] e cila hyn në lokalit e të dëmtuarit M [redacted] E [redacted] punëtor në lokalit e këpucëve "[redacted]" e cila gjendet në Suharekë ku blenë një palë këpucë duke dorëzuar paranë në shumë prej 50 € me nr. serik U 91558726062, ndërsa punëtori bënë pagesën dhe kthen kusurin ku më pas i njejt dyshon se paraja është e falsifikuar dhe menjëherë njofton Stacionin e policisë e të cilët më pas permes kamerave identifikojnë të akuzuarën e cila pas disa dite ftohet në Stacionin e policisë e të cilët më pas përmes kamerave indentifikojnë të akuzuarën e cila pas disa dite ftohet në Stacionin e Policisë në Pejë së bashku me të akuzuarin M [redacted] R [redacted] për të dhënë deklaratë, derisa nga i dëmtuari paraja e përdorur konfiskohet si objekt i kryerjes së veprës penale me ç'rast dërgohet në ekzaminim laboratorit pranë Agjensionin Kosovar për Forenzik, ku në bazë të ekspertizës së dhënë me numër AKF/2017-1147/2017-1041, është konstatuar se paraja është e falsifikuar.



-me këtë kanë kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 3 në lidhje me nenin 31 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 8, 9, 10, 21, 31, 41, 42, 43, 46, 69, 73, 74, 75 paragrafi 1 nënparag. 1.3, 76 dhe nenet e përmendur më lartë të KP, i

G J Y K O N

-të akuzuarin M [REDACTED] R [REDACTED], me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar të paguajë 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit;

-e akuzuara B [REDACTED] H [REDACTED], me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar të paguajë 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit;

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë apo nuk mund të paguajnë dënimin me gjobë, gjykata mund ta zavendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg, në mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të llogaritet një ditë burg, çka do të thotë me 10 ditë burgimi.

Konfiskohet kartmonedha në vlerë prej 50 €, me nr. Serik U 91558726062 si objekt i kryerjes së veprës penale.

Obligohen të akuzuarit, që të dëmtuarit M [REDACTED] B [REDACTED] t'ia kthejnë 50€ në emër të kërkesës pasuroro-juridike.

Obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor solidarisht të paguajnë shumën prej nga 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I. nr. 58/17 të datës 05.05.2017 kundër të akuzuarve M [REDACTED] R [REDACTED] dhe B [REDACTED] H [REDACTED], të dytë nga fshati [REDACTED], KK Pejë, për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 3 në lidhje me nenin 31 të KP-së.

Pas pranimit të shkresave të lëndës kryetarja e trupit gjykues ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën 29.06.2017 ku Prokurori i Shtetit pas leximit të aktakuzës ka mbetur pranë saj. Pas udhëzimeve të mjaftueshme nga kryetarja e trupit gjykues, të akuzuarit duke kuptuar të dhënat nga aktakuza dhe të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 3 në lidhje me nenin 31 të KP-së, në të cilën deklarata Prokurori i shtetit nuk ka pasur vërejtje, me propozim që gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënim duhet të ketë parasysh rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe atë përveç pranimit të fajësisë edhe se janë të rinj, qëndrimin korrekt dhe kooperues me organet e ndjekjes si dhe premtimin se nuk do të përsërisin ndonjë vepër inkriminues dhe se deri më tani nuk kanë qenë të dënuar.

Kryetarja e trupit gjykues pas dëgjimit të palëve pasi që ka qenë i bindur se të akuzuarit kanë kuptuar aktakuzën dhe drejtat e tyre, kanë kuptuar natyrën dhe pasojat



e pranimit të fajtit, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas këshillimeve të mjaftueshme, pranimi i fajtit mbështetet në faktet e çështjet që e përmban aktakuza dhe materialeve të propozuar nga Prokurori i Shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të çartë ligjore ose gabime faktike ka pranuar pranimin e fajësisë prej të akuzuarit, për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 3 në lidhje me nenin 31 të KP-së.

Në bazë të pranimit të fajësisë së të akuzuarve dhe provave materiale në shkresat e lëndës është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Me datë 24.03.2017 rreth orës 19:00 në Suharekë, i akuzuari M. R. vënë në qarkullim si të vërtetë paranë e falsifikuar prej 50 € në atë mënyrë që pasi kishte pas në posedim paranë e falsifikuar e me qëllim që paranë në fjalë të vënë në qarkullim si të vërtetë ia dorëzon bashkëshortes së tij të akuzuarës B. H. e cila hyn në lokalin e të dëmtuari M. E., ku blen një palë këpucë duke dorëzuar paranë në shumë prej 50 € me nr. serik U91558726062, ndërsa i dëmtuari bënë pagesën dhe kthen kusurin ku më pas i njëjti dyshon se paraja është e falsifikuar dhe menjëherë njofton Stacionin e policisë e të cilët më pas përmes kamerave identifikojnë të akuzuarën e cila pas disa dite ftohet në Stacionin e policisë në Pejë së bashku me të akuzuarin M. R. për të dhënë deklaratë, derisa nga i dëmtuari paraja e përdorur konfiskohet si objekt i kryerjes së veprës penale me ç'rast dërgohet në ekzaminim laboratorit pranë Agjensionit Kosovar për Forenzik, ku në bazë të ekspertizës së dhënë me numër AKF/2017-1147/2017-1041, është konstatuar se paraja është e falsifikuar.

Duke pasur parasysh se në shqyrtimin fillestar, me respekt paraprak të gjithë të drejtave e të akuzuarve, të garantuara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarit vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohen, në bazë të neni 248 KPP-së, i cili pranim ka të bëjë si me tërë përshkrimin e ngjarjes nga rrjedhin elementet e veprës penale e cila vihet në barrë me aktakuzë, ashtu edhe me përshkrimin sipas ligjit të veprës të argumentuara dhe me kualifikim të tillë sa që japin fakte të cilat janë në kuadër të Ligjit. Në bazë të cekurave gjykata edhe nuk ka administruar provat dhe ka pranuar pranimin e fajësisë së të akuzuarit duke mos gjetur se ekzistojnë provat e papranueshme dhe duke konsideruar se pranimi i fajësisë është vërtetuar me fakte të cilat janë në kuadër të fakteve të tjera të vërtetuara me provat të prezantuara, të cilat prova udhëzojnë në ekzistimin e veprës penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë.

Në bazë të gjitha të cekurave më lartë gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer me dashje veprën penale, tek e cila vepër penale dashja ka ekzistuar sepse të akuzuari kanë qenë të vetëdijshëm se përdorimi i parasë së falsifikuar si të vërtetë, paraqet një veprim të kundërligjshëm, prandaj konsideron se në veprimet e tyre formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtorë dhe dënuar sipas ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke gjetur si rrethanë rënduese rrezikun shoqëror dhe rrezikimi i së mirës së mbrojtur, ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë sjellja korrekte gjatë tërë procedurës, se janë të gjendjes së dobët ekonomike, rrethanat familjare- bashkëshortë me dy fëmijë, pendimi dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla, të gatshëm të kompensojnë palën e



dëmtuar, e po ashtu edhe pranimi i fajësisë, prandaj gjykata, duke marrë parasysh nenin 75 par. 1 nënpar.1.3 të KP, i ka gjykuar me dënim me gjobë, duke konsideruar se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 të KPP.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 463 par.2 KPP.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marrë në bazë të nenit 69 të KP.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.58/17 të dt.29.06.2017

Sekretarja juridike
Valdete Zurnaxhiu

Përkthyesi gjyqësor
Asnije Berisha

Kryetari i trupit gjyqësor
Raima Elezi

UDHËZIM JURIDIKË: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së aktgjykimit, nëpërmjet kësaj gjykata, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

